

Nr. 5031 / 1 Prot

Dt. 11.10.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr 632/1prot.

Shkodër, më 7.10.2022

LËNDA: Mbi vendimin Nr.61 datë 23.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", Urdhërit të Ministrisë të Brendshme Nr.175, datë 9.07.2020 "Për miratimin e rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut"si dhe aneksi 1 "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", Kreu II, neni 4, neni 9, pika 1/1.2 germa a dhe c, neni 27 pika 5, neni 54 shkronja e/1, neni 55 pikat 3 të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, ligjit Nr.57/2020 "Për pyjet" neni 25 pika 1/a, VKM Nr.433 datë 08.06.2016 "Për Transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive" i ndryshuar, pika 49, shtojcës nr.47, Udhëzimit të Ministrisë të Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shyrimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjorë dhe kullor publik", pika 2 germa a, dhe pika 7, VKB Vau-Dejës Nr.6 datë 26.01.2022 "Për miratimin e listës të ngastrave dhe nëngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim", dokumentacionin shoqërues të mbledhjes së KB Vau-Dejës datë 23.09.2022 dërguar nga Sekretari i Këshillit bashkiak Vau-Dejës Nr.5022 prot datë 28.09.2022 u shqyrtua VKB Nr.61, datë 23.09.2022 Vau-Dejës "Për ndryshimin e VKB Vau-Dejës Nr.57 datë 26.10.2020 afatin e marrjes me qera nga 9 nëntë vite ne 10 vite, për sipërfaqen pyjore prej 0.347ha, ngastra 40/a, ekonomia pyjore Shllak 1, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqerore dhe veprimtari turistike, kampingje".

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm sipas autorizimit të Këshillit Bashkiak me zgjatje afati nga 9 nëntë vite ne 10 vite. Në vëmendje VKM re Nr.559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike si dhe për prodhime drusore dhe jo drusore pyjore".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 61 datë 23.09.2022

“Për ndryshimin e vendimit nr 57 datë 26.10. 2020 të afatit të marrjes me qira nga 9 (nëntë) vjeçar në 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 0.347 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj”, në ngastrat nr.40/a në ekonominë pyjore Shllak 1.

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020, date 30.4.2020 “Për Pyjet”, neni 25, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” *me shumicë të cilësuar votash.*

V E N D O S I

1. **Ndryshimin e vendimit nr 57 datë 26.10. 2020 të afatit të marrjes me qira nga 9 (nëntë) vjeçar në 10 vjeçar për sipërfaqen pyjore prej 0.347 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj”, në ngastrat nr.40/a në ekonominë pyjore Shllak 1.,**
2. Afati i dhënies me qira të jetë 10 (dhjetë) vjet.
3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për vëprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.
4. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti , sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
5. Ngarkohen Drejtorja e pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

K R Y E T A R

Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian Çelepija

Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 28.09.2022